



# Tax Alert Albania

## January 2023



# PwC Albania - Tax Alert

**The Combined Nomenclature of Goods for 2023 is officially approved and published, and extends its effects from 1 January 2023.**

Source: [Link](#)

## **A change in law no. 61/2012 "For excise duties in the Republic of Albania" amended**

There is a change in the tax rate of the goods subject to excise duty in the Republic of Albania", according to appendix 1, is attached to law no. 61/2012, "On excise duties in the Republic of Albania", amended. The tax rate for beer, which was 360 All/HL for domestic/foreign entities producing less than 200 000 HL within a year. Meanwhile with the new law coming to force, gets unified and becomes 710 All/HL for all entities.

For spirituous beverages (Whisky, Gin, Vodka, etc) the tax rate becomes 84 500 All/HL for all entities, from 65 000 All/HL that it was for entities producing <=200 000 HL/per year.

For cigarettes that contain tobacco a tax rate increase by 250 All/kg is foreseen each year, with an excise of 7000 All/kg from 1 January 2023.

Source: [Link](#)

## **Standard 15 "On accounting and financial reporting of micro-economic entities", improved**

Micro-economic entities, despite their income, must prepare, present and publish condensed financial statements at least once a year. However, note that this amendment will be applied prospectively from 1 January 2028, i.e without changing the comparative financial statements of 2027, which have been prepared according to the existing accounting requirements.

Source: [Link](#)

## **Changes to instruction no. 23, dated 9.12.2014, 'On the collection of mandatory social and health insurance contributions'**

In the payroll's column "category no. of employees regarding contributions", a predetermined number is noted, representing the category of the employee for the purposes of the declaration and the calculation of contributions. Category 31 remains similar in content, but the time limit "after the 14th day" is removed.

Meanwhile, categories 32 and 33 are added:

"Category 32. Employee, who for the whole month has been on a medical report after the 14th day and receives benefits from the social insurance scheme, but has not severed (resolved) work relations with the relevant employing subject."

"Category 33. Employees with disabilities, including deaf people and work invalids assessed as partially able to work by the relevant commissions, for whom the obligation to pay contributions from the employer arises, according to the provisions of law no. 15/2019, "For promoting employment."

Source: [Link](#)

**Miratohet dhe publikohet zyrtarisht Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave 2023 që hyn në efekt nga 1 janar 2023.**

Burimi: [Link](#)

## **Ndryshim në ligjin 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar**

Ndryshon shkalla e tatimit për disa nga mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar." Unifikohet shkalla e tatimit për birrën e bërë nga malto, në 710 lekë/HL për të gjitha subjektet (nga 360 lekë/HL që ishte për subjektet vendase/ të huaja që prodhonin më pak se 200 000 HL në vit).

Për pijet alkoolike (Whisky, Gin, Vodka, etj)shkalla e tatimit bëhet 84 500 lekë/HL për të gjitha subjektet prodhuese, nga 65 000 lekë/HL që ishte për subjektet që prodhonin <=200 000 HL/vit.

Për cigaret që përmbajnë duhan parashikohet një rritje e shkallës së tatimit me 250 lekë/kg çdo vit, me akcizë 7000 lekë/kg që nga 1 janari 2023).

Burimi: [Link](#)

## **Standardi 15 "Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike", i përmirësuar**

Për mikronjësitë pavarësisht të ardhurave që realizojnë, bëhet e detyrueshme përgatitja, paraqitja dhe publikimi i pasqyrave financiare të shkurtuara të paktën një herë në vit.

Megjithatë, ky ndryshim do të zbatohet në mënyrë prospektive nga data 1 janar 2028 d.m.th pa ndryshuar pasqyrat financiare krahasuese të vitit 2027, të cilat janë përgatitur sipas kërkesave ekzistuese të kontabilitetit.

Burimi: [Link](#)

## **Ndryshim në udhëzimin nr. 23, datë 9.12.2014, 'Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore'**

Në rubrikën e listëpagesave "Nr. i kategorisë të punonjësve për kontributet", shënohet një numër i paracaktuar që përfaqëson kategorinë e punonjësit për efekt të deklarimit dhe llogaritjes së kontributeve. Kategoria 31 qëndron e njëjtë në përmbajtje, por hiqet përcaktimi kohor "pas ditës së 14".

Shtohen kategoritë 32 dhe 33:

"Kategoria 32. I punësuar, i cili për gjithë muajin ka qenë me raport mjekësor pas ditës së 14 dhe merr përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, por nuk i ka shkëputur (zgjidhur) marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës."

"Kategoria 33. I punësuar me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse, për të cilët lind detyrimi i derdhjes së kontributeve nga punëdhënësi, sipas dispozitave të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit."

Burimi: [Link](#)

# PwC Albania - Tax Alert

## Law No. 82/2022, 'For some additions and changes in the law no.92/2014, "On Value Added Tax in the Republic of Albania"'

The supply of wood as fuel, in logs, in branches, or similar forms, is exempt from VAT, with effect until **31 December 2023**." (Article 51) This supply is also exempt from VAT on import until 31 December 2023 (heading 4401 of the Combined Nomenclature).

Goods meant to be used for the execution of projects financed by the funds received on the basis of a donation/grant agreement, concluded between the Council of Ministers of the Republic of Albania/ Republic of Albania and foreign donors, if the agreement foresees that the funds received will not be used to pay taxes are supplies **exempt from VAT on import**. These supplies will be treated as **supplies similar to exports**.

Section 6 is added, "**Special Regime for the Albanian Electricity Exchange**". The import and the supply of electricity within the country, destined to be sold through the Albanian Energy Exchange, is exempt from value added tax (art. 155/2).

When the supply of electricity is traded through the Albanian Electricity Exchange, VAT becomes payable at the moment that the results are announced in the Daily Auction Markets in Advance or Intraday or at the moment when orders are matched in the case of Continuous Intraday Market (art 155/3).

Until 31 December 2026, the buyer of electricity from the Albanian Electricity Exchange performs the VAT reverse-charge as the person responsible for the VAT payment.

This law extends its effects from 1 January 2023.

Source: [Link](#)

## Amendments and Additions to Law no. 9920, Date 19.5.2008, "On Tax Procedures in the Republic of Albania"

The taxpayer who issues invoices, is obliged to deposit the money (banknotes and coins) that has been accumulated during the day for the supply of goods or services, which exceeds the maximum level of the cash register, in accordance with Article 59/2 of this law, in his bank account or in his account opened in another non-banking financial institutions, **the next working day, after the day that the maximum cash register has been exceeded. (neni 59/1)**

### Article 59/2 "Cash limit"

The amount of cash is the initial amount of money that the taxpayer can have in his cash register at the beginning of the working day or for each operator shift. The maximum amount of cash is independently determined by the taxpayer, but this cannot exceed:

- ALL 150,000, for taxpayers with annual turnover, during the previous tax year, up to ALL 2 million;
- ALL 500,000, for taxpayers with annual turnover from ALL 2 million to ALL 10 million;
- ALL 500,000 or 5% of the annual turnover of the previous year, whichever is the higher value, for taxpayers with an annual turnover over ALL 10 million.

## Ligji Nr. 82/2022, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë"'

Përfshihet nga TVSH-ja furnizimi i drurit si lëndë djegëse, në kërcunj, në kopaçe, në degë, në shkarpa apo forma të ngjashme, me efekt deri në **31 dhjetor 2023**."(neni 51) Këto furnizime përfshihen dhe nga TVSH në import, me efekt deri në 31 dhjetor 2023 (neni 56).

**Përfshihen nga TVSH në import (neni 56)** mallrat e destinuar për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/ Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime. Këto furnizime do të trajtohen si **furnizime të ngjashme me eksportet**.

Shtohet Seksioni 6, "**Regjimi i veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë**". Përfshihen nga tatimi mbi vlerën e shtuar importimi dhe furnizimi brenda vendit i energjisë elektrike të destinuar për tu shitur nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë (neni 155/2).

Në rastin e furnizimit të energjisë elektrike të tregtuar nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, TVSH-ja bëhet e kërkueshme në momentin kur shpallen rezultatet në Tregjet e Ankandëve të Ditës në Avancë ose Brenda së Njëjtës Ditë ose në momentin kur urdhëri porositë përputhen në rastin e Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë (neni 155/3).

Deri më 31 dhjetor 2026, blerësi i energjisë nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, kryen autongarkesën (reverse-charge) e TVSH-së në cilësinë e personit përgjegjës për pagesën e TVSH-së.

Ky ligj i shtrin efektet nga 1 janari 2023.

Burimi: [Link](#)

## Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 9920, Datë 19.5.2008, "Për Procedurat Tatimore Në Republikën E Shqipërisë"

Tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet që t'i depozitojë në llogarinë e vet bankare ose në llogarinë e tij të hapur në institucione të tjera financiare jobankare, paratë (kartëmonedha dhe monedha) që ka grumbulluar gjatë ditës, të cilat tejkalojnë nivelin maksimal të arkës, në përputhje me nenin 59/2 të këtij ligji, **ditën e nesërme të punës, pas ditës që maksimumi i arkës është tejkalluar. (neni 59/1)**

### Neni 59/2 "Limiti i arkës"

Shuma e parave cash është shuma fillestare e parave që tatimpaguesi mund të ketë në arkën e tij në fillim të ditës së punës ose të ndërrimit të çdo operatori. Shumën maksimale të parave cash e përcakton tatimpaguesi në mënyrë të pavarur, kjo nuk mund të jetë më shumë se:

- 150 000 lekë, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor, gjatë vitit të mëparshëm tatimor, deri në 2 milionë lekë;
- 500 000 lekë, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 2 milionë lekë deri në 10 milionë lekë;
- 500 000 lekë ose 5% të qarkullimit vjetor të vitit të kaluar, cilado qoftë vlera më e lartë, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 10 milionë lekë.

# PwC Albania - Tax Alert

The maximum cash amount of the cash register does not apply to banks and other non-banking financial institutions.

The taxpayer, who performs currency exchange transactions, can determine the maximum amount of cash up to the amount of ALL 5,000,000 or 5% of the annual turnover of the previous year, whichever is the higher value.

The taxpayer, is obliged to submit the information on the initial amount of cash in the cash register, through the system used for the fiscalization procedure, at the beginning of each working day.

In Article 80 "**Tax control**": For the controls performed by the central tax administration, the authority to initiate the tax control is the Regional Tax Directorate or other units in the General Directorate of Taxation with the same functions.

## Amendments in fine penalties:

Failure to comply with the obligation to register or the obligation to update data is punished for each violation with a fine of ALL 10,000 for natural persons and ALL 15,000 for legal entities (art. 112).

A fine of ALL 3,000 is added for individual taxpayers for each tax return not submitted on time (art. 113).

The fine for **non-payment on time of the preliminary installments of the tax on corporate income and the tax on personal income** from business and self-employment is 10 percent of the amount of the installment to be paid plus the **late interest** for the days calculated but not more than 365 days (art. 114/1).

The penalty for **failure to keep correct books, registers and documentation** is ALL 10,000 for each violation, in cases where it is a natural person exercising commercial economic activity or self-employed, and ALL 50,000 when it is a legal entity (art. 118).

In Article 119, **non-declaration of the correct salary** received by the employee; the employer, in addition to the obligation to pay the amount of the tax liability and contributions for this employee, calculated for the entire period, shall be punished with a fine in the amount of:

- 200% of the liability and contribution calculated for legal entity taxpayers, instead of ALL 200,000 required previously;
- 100% of the obligation and contribution for all other taxpayers, instead of ALL 50,000 required previously.

For the taxpayer, who, for the second time within the calendar year, commits a violation, the fine for corporate income tax becomes ALL 500,000 from ALL 150,000 that was before (art. 123).

Source: [Link](#)

Shuma maksimale cash e arkës nuk zbatohet për bankat dhe institucionet e tjera financiare jobankare.

Tatimpaguesi, i cili kryen transaksione këmbimi monedhe, mund të përcaktojë maksimumin e arkës deri në shumën 5 000 000 lekë ose 5% të qarkullimit vjetor të vitit të kaluar, cilado qoftë vlera më e lartë.

Tatimpaguesi detyrohet në fillim të çdo dite pune, në sistemin që përdor për procedurën e fiskalizimit, të paraqesë informacionin mbi shumën fillestare të parave cash në arkë.

Në nenin 80 "**Kontrolli tatimor**": Për kontrollet e kryera nga administrata tatimore qendrore, autoritetin për të iniciuar kontrollin tatimor e ka Drejtoria Rajonale Tatimore ose njësitë e tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me funksione të njëjta me të.

## Ndryshime në dënimet me gjobë:

Mosrespektimi i detyrimit për regjistrim apo detyrimit për përditësimin e të dhënave dënohet për çdo shkelje me gjobë prej 10 000 lekë për personat fizikë dhe 15 000 lekë për personat juridikë (neni 112).

Shtohet dënimi me gjobë me vlerë 3 000 lekë për tatimpaguesit individë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar në afat (neni 113).

Gjoha për **mospagimin në afat të kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin korporativ dhe tatimit mbi të ardhurat personale** nga biznesi dhe vetëpunësimi, bëhet në masën 10 për qind të shumës së kështit për t'u paguar plus **kamatëvonesën** e llogaritur për ditët e vonuara, por jo më shumë se 365 ditë (neni 114/1).

Dënimi me gjobë për **mosmbajtjen e saktë të librave, regjistrave dhe dokumentacionit** bëhet 10 000 lekë për çdo shkelje, në rastet kur është person fizik që ushtron veprimtari ekonomike tregtare apo si i vetëpunësuar dhe 50 000 lekë kur është person juridik (neni 118).

Në nenin 119, **mosdeklarimi i pagës së saktë** të përfituar nga punëmarrësi; punëdhënësi përveç detyrimit për pagimin e shumës së duhur të detyrimit tatimor dhe kontributet për këtë punonjës, të llogaritur për gjithë periudhën e provuar sa është kryer shkelja, dënohet me gjobë në masën:

- 200% të detyrimit dhe kontributit të llogaritur për tatimpaguesit entitete juridike, nga 200 000 lekë që ishte më përpara;
- 100% të detyrimit dhe kontributit për të gjithë tatimpaguesit e tjerë, nga 50 000 lekë që ishte më përpara.

Për tatimpaguesin, i cili, për herë të dytë brenda vitit kalendarik, kryen një shkelje, gjoha e tatimit mbi fitimin korporativ bëhet 500 000 lekë nga 150 000 lekë që ishte më përpara (neni 123).

Burimi: [Link](#)



# Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania  
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: [al\\_pwc\\_albania@pwc.com](mailto:al_pwc_albania@pwc.com)

Web: [www.pwc.com/al](http://www.pwc.com/al)

